



BURSA PËR STUDIME PASUNIVERSITARE NË KORENË E JUGUT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019

Ministria e Arsimit të Republikës së Koresë së Jugut në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Arsimin Ndërkombëtar (NIIED) shpall programin e bursave: “2018 Global Korea scholarships” për studentët e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pasuniversitare në Korenë e Jugut.

Programi i Bursave të Qeverisë Koreane (Program-NIIED GKS/2018 Graduate GKS) për studentët ndërkombëtarë, i cili sponsorizohet nga Instituti Kombëtar për Arsimin Ndërkombëtar (NIIED), synon të promovojë shkëmbimin ndërkombëtar dhe partneritetet të ndërsjellë midis vendeve pjesëmarrëse.

Kandidatët pasuniversitare të interesuar për këtë lloj aplikimi duhet të kenë kualifikimin e domosdoshëm. Ata duhet të kenë përfunduar studimet në programe bachelor ose master pranë universiteteve ose shkollave të larta në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit.

Shpenzimet e udhëtimit, tarifat e shkollimit si dhe bursa mujore do të mbulohen nga Instituti Kombëtar për Arsimin Ndërkombëtar (NIIED), në kuadër të Programit të Bursave të Qeverisë Koreane (Korean Government Scholarship Program-NIIED GKS-KGSP).

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve pranë Ambasadës Koreane në Athinë / Greqi është **data 16 mars 2018.**

Për një informacion më të detajuar për kushtet e aplikimit për bursat e Qeverisë së Koresë së Jugut, ju lutemi referojuni materialeve informative bashkëlidhur këtij njoftimi, si dhe adresave në vijim:

Web: <http://www.studyinkorea.go.kr>

Contact point: Ms. Aggeliki KO,

e-mail: gremb@mofat.go.kr;

Web: grc.mofat.go.kr;

Tel: (30) 210 6984080-2

Fax: (+30) 210.698.40.83

Address: South Korean Embassy
19th floor, Athens Tower A Building
2 Messogion Avenue
115 26 Athens
Greece

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS